

Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

NR I VENDIMIT:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/C/160/2012
06/06/2012

URDHËR

(1) Në 5 (pesë) kërkesat e referua në pjesët A dhe C të listës së bashkangjitur,
Komisioni

vendos që

*Paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka
dëshmuar pronësinë për pronën e kërkuar;*

(2) Në kërkesën nr. 00057, të referuar në pjesën B të listës së bashkangjitur,
Komisioni

vendos që

*Bartësi i së drejtës pronësore ka dëshmuar të drejtën e shfrytëzimit për
pronën e kërkuar;*

(3) Në secilën prej 6 (gjashtë) kërkesave të identifikuara në paragrafët (1) dhe (2) më
sipër, Komisioni

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, sipas
rastit, t'i jepet posedimi për pronën e kërkuar;

(b) Çdo person, i cili e ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta
lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij
urdhri; dhe

- (c) Nëse çdo person tjetër i cili e ka uzurpuar pronën dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona.
- (4) Komisioni më tutje vendos që kërkesa nr. 10024 të hidhet poshtë kur paraqitësi i kërkesës kërkon kompensimin për humbjen e shfrytëzimit për pronën e kërkuar.
- (5) Në 12 (dymbëdhjetë) kërkesat e identifikuar në pjesën D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.
- (6) Në kërkesën nr. 11554, të referuar në pjesën E të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullosës së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.
2. Sipas nenit 22 të Rregullosës së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullosës së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhrë nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:
 - (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
 - (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejtë të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullosës së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposëdim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e nëntë nga 4 deri 6 qershor 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 21 kërkesa për pronë komerciale në seancën e njëzetë e nëntë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Të njëzet e një kërkesat për pronë komerciale u vendosën nga Komisioni gjatë kësaj seance, nëntëmbëdhjetë kërkesa janë trajtuar në këtë vendim dhe dy kërkesa në vendimin KPCC/D/C/161/2012.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuar të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim

7. Ky vendimi zbatohet për nëntëmbëdhjetë kërkesat komerciale të paraqitura Komisionit gjatë seancës së njëzet e nëntë. Në secilin prej këtyre kërkesave, me përjashtim të kërkesave nr. 00057, 00974, 08840, 11554, 11582, 11589 dhe 16518, paraqitësi i kërkesës kërkon zgjidhjen e kërkesës pronësore. Në kërkesat nr. 00057, 00974, 08840, 11554, 11582, 11589 dhe 16518 paraqitësit e kërkesës kërkojnë konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

8. Komisioni vëren se pesë kërkesat e identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur si edhe kërkesa nr. 11220 e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr.

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhërësën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni konstaton se Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

9. Komisioni vëren më tej se katërmbëdhjetë kërkesat e identifikuara në pjesët C, D dhe E të listës së bashkangjitur me përjashtim të kërkesës nr. 11220, janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara (“Pala përgjegjëse”) ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme të procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Në bazë të nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, palës përgjegjëse i është ofruar një kopje e kërkesës të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës. Në përputhje me nenin 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësit të kërkesës, i është ofruar një kopje e dokumenteve të siguruara nga pala përgjegjëse në përgjigje të kërkesës. Të dy palëve në secilin rast, u është dhënë mundësia për të komentuar për informacionin e ofruar nga pala tjetër dhe komentet apo informacioni i tillë janë marrë në konsideratë gjatë përpunimit dhe vendosjes së kërkesës.

1. Kërkesa jokontestuese të miratuara

10. Komisioni vëren se në kërkesat e identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave për pronësinë, përfshirë vendimet për trashëgiminë, fletët poseduese, certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme, kontratat e shitblerjes, vendimi i ndarjes dhe vendimet e gjykatës për njohjen e pronësisë. Komisioni është i kënaqur se vendimet e trashëgimisë që konfirmojnë interesin pronësor me të vërtetë përbëjnë dëshmi të pronësisë. Dokumentet e tjera të dorëzuara nga paraqitësit e kërkesave përfshirë fletët poseduese dhe kontratat që përfshijnë transaksione pronësore krijojnë një supozim të kundërshtueshëm të së drejtës pronësore. Nuk është marrë ose nuk është kërkuar *ex officio* nga Sekretaria asnjë provë që do të kundërshtonte supozimin e të drejtës pronësore. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se dokumentet e dorëzuara provojnë të drejtën pronësore të paraqitësve të kërkesave për pronat e kërkuara. Dokumentet janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vlefshme dhe konsiderohen si relevante.

a. Kërkesa nr. 00057

11. Në kërkesën nr. 00057, të referuar në pjesën B të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar pikërisht një garazh. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti dokumente të ndryshme duke përfshirë kontratën e shfrytëzimit të datës 20 shtator 1988. Bazuar në konstatimet e Komisionit në paragrafin 10 më sipër, kërkesa e paraqitësit të kërkesës të miratohet.

b. Kërkesat nr. 10000 dhe 10024

12. Në kërkesën nr. 10000 dhe 10024, të referuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit dhe riposedimin. Bazuar në konstatimet e Komisionit në paragrafin 10 më sipër, këto kërkesa duhet të miratohen.

c. Kërkesa nr. 13140

13. Në kërkesën nr. 13140, të referuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare në bazë të nenit 1.2 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Neni 1 i Urdhërësës Administrative e miratuar me ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë qëndruar në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Paraqitësi i kërkesës i cili është vëllai i mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, bie në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare. Rrjedhimisht, bazuar në konstatimet e Komisionit në paragrafin 10 më sipër, kërkesa duhet të miratohet.

2. Kërkesa kontestuese të miratuara

a. Kërkesa nr. 01135

14. Në kërkesën nr. 01135, të referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pohon se e ka blerë pronën e kërkuar (dyqan) nga Armata Kombëtare Jugosllave në janar 1999. Në bazë të kontratës së blerjes, e cila është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës ka përfutur të drejtën pronësore për lokalin komercial dhe të drejtën e përhershme të shfrytëzimit për token, ndërsa pronësia e tokës i mbetet Armatës Kombëtare të Jugosllavisë. Paraqitësi i kërkesës e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar deri në shtator 1999 kur ai u detyrua nga persona të panjohur që të largohej nga prona.

15. Pala përgjegjëse e kërkesës e cila ka uzurpuar pronën e kërkuar është organizata joqeveritare “Nënë Tereza.” Përfaqësuesi i autorizuar i palës përgjegjëse deklaroi se e konsideron pronën në pronësi të shtetit. Megjithatë pala përgjegjëse dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të këtij pohimi.

16. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konfirmon të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës për lokalin e kërkuar komercial (dyqan) dhe të drejtën e tij të shfrytëzimit për token.

b. Kërkesa nr. 16127

17. Në kërkesën nr. 16127 të referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Ai pohon se në vitin 1972 ai përfitoi të drejtën e banimit për një banesë

dhe garazh. Kjo kërkesë ka të bëjë me garazhin. Në vitin 1989, punëdhënësi i paraqitësit të kërkesës, Ndërmarrja Shoqërore *PIK Kosovo-Export* e shkëmbeu banesën që i ishte ndarë fillimisht me një banesë më të madhe me Ndërmarrjen Publikë Banesore. Banesa me e madhe iu nda paraqitësit të kërkesës. Megjithatë, garazhi, subjekt i kërkesës, nuk ishte pjesë e shkëmbimit dhe mbeti në posedim të paraqitësit të kërkesës. Në vitin 1993, paraqitësi i kërkesës e privatizoi banesën dhe garazhin. Në mbështetje të pretendimeve të tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti kontratën për shfrytëzimin e garazhit të datës 19 tetor 1972 dhe kontratën e blerjes së banesës dhe garazhit të datës 24 qershor 1993. Te dy dokumentet u konstatuan si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive.

18. Pala përgjegjëse i cili është duke shfrytëzuar aktualisht pronën e kërkuar pohon se e ka blerë pronën e kërkuar nga një palë e tretë në vitin 2005. Në mbështetje të pohimeve të tij, ai ofroi një kontratë shitje të një banesë që nuk lidhet me pronën e kërkuar. Kontrata në fjalë nuk e përmend garazhin të jetë pjesë e transaksionit. Pala përgjegjëse nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi në mbështetje të së drejtës pronësore të pretenduar për pronën e kërkuar.

19. Bazuar në dëshmitë para tij, kërkesa e paraqitësit të kërkesës për të drejtën pronësore për garazhin duhet të miratohet.

3. *Kërkesa të hedhura poshtë ose të refuzuara.*

20. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

21. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

22. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

23. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të

Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit.)

24. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj mbi pronën e kërkuar.

a. Kërkesat nr. 00034 dhe 00066

25. Në kërkesën nr. 00034, të referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Ai pohon se e bleu pronën e kërkuar pikërisht dyqanin në vitin 2005. Pala përgjegjëse i cili po e shfrytëzon lokalin pretendon se djali i tij e ka blerë pronën në vitin 2006 nga një palë e tretë. Më 4 nëntor 2005, paraqitësi i kërkesës inicioi padi në Gjykatën Komunale të Prishtinës për konfirmimin e së drejtës pronësore për pronën e kërkuar.

26. Në kërkesën nr. 00066, e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se e ka blerë pronën në vitin 1990 nga Vehbi Kurtalini i cili sipas paraqitësit të kërkesës, ia ka shitur pronën e njëjtë Ahmet Demirit në vitin 1991. Pala përgjegjëse i cila është duke shfrytëzuar aktualisht pronën pretendon se e ka blerë pronën në vitin 2001 nga Ahmet Demiri. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se në vitin 2002 ka depozituar padi në Gjykatën Komunale në Gjilan ku kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore.

27. Në bazë të nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse ka filluar procedimi gjyqësor në lidhje me kërkesën para 16 tetorit 2006, datë në të cilën ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Pasi për kërkesat nr. 00034 dhe 00066, procedimi gjyqësor në lidhje me pronat e kërkuara ka filluar në vitin 2005 dhe 2002 respektivisht, këto kërkesa nuk janë në juridiksion të Komisionit dhe rrjedhimisht duhet të hidhen poshtë.

b. Kërkesa nr. 00064

28. Kërkesa nr. 00064 e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur, është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës pretendon se babai i tij ka qenë pronar i pronës së kërkuar dhe se ai është shpronësuar në vitin 1969. Paraqitësi i kërkesës nuk pretendon se e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar si rezultat i rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që

rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-1999. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

c. Kërkesa nr. 00086

29. Kërkesa nr. 00086 e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur, është depozituar nga përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës është ndërmarrja “Jadroagent” e cila kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposelimin. Përfaqësuesi i paraqitësit të kërkesës pretendon se në vitin 1977, prona është shkëmbyer me një prone tjetër që e ka pasur në pronësi paraqitësi i kërkesës përmes një kontratë shkëmbimi me *Posten dhe Telekomin e Kosovës* (PTK). Pala përgjegjëse i cili është duke shfrytëzuar pronën pretendon se e ka blerë pronën nga PTK-ja në vitin 1999.

30. Në vitin 2001, paraqitësi i kërkesës depozitoi padi në Gjykatën Komunale të Prishtinës duke kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore dhe riposelimin. Me aktgjykimin e 2 prillit 2002, gjykata konfirmoi të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës dhe lëshoi një urdhër dëbimi. Ky vendim mori formën e prerë më 4 shtator 2002.

31. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me ligjin nr. 03/L-079, Komisioni mund të hedhë poshtë një kërkesë e cila është shqyrtuar më parë dhe vendosur me vendim administrativ ose gjyqësor të formës së prerë. Aktgjykimi i datës 2 prill 2002 i Gjykatës Komunale të Prishtinës përben *res judicata*, dhe kështu kërkesa duhet të hidhet poshtë.

d. Kërkesa nr. 00121

32. Paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesën nr. 00121 e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar, pikërisht zyrën, në vitin 2005. Pala përgjegjëse, i cili po e shfrytëzon pronën aktualisht ka qenë në posedim të pronës në atë kohë dhe nuk e ka humbur posedimin që nga ajo kohë. Pala përgjegjëse pretendon të drejtë pronësore për pronën e kërkuar por dështoi ta provojë të drejtën e pretenduar pronësore apo të paraqitë dëshmi në mbështetje të saj.

33. Komisioni vëren se kërkesa e paraqitësit të kërkesës nuk ka lindur në rrethana të lidhur me konfliktin e vitit 1998-99. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

e. Kërkesa nr. 00974

34. Paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesën nr. 00974 e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Ajo pretendon se ka pasur të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar, pikërisht zyrën. Pala përgjegjëse, i cili është shfrytëzuesi aktual i pronës pretendon se ai është qiramarrës i rregullt i pronës që nga viti 2007.

35. Komisioni vëren se, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesës së saj, afati i përkohshëm i shfrytëzimit ka skaduar më 28 shtator 1999 pas vazhdimit prej tri muajsh nga 1 tetori 1999 deri 31 dhjetor 1999. Paraqitësi i kërkesës është larguar nga Kosova më 2000 si rezultat i konfliktit. Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin e

pronës së kërkuar si rezultat i konfliktit por për shkak të skadimit të kontratës së qirasë. Kështu, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

f. Kërkesat nr. 08840, 16518 dhe 33936

36. Në kërkesën nr. 08840 e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësor. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti vendimin e ndarjes të viti 1989 që i miraton atij të drejtën e përkohshme për shfrytëzimin e pronës dhe lejen për të ndërtuar një strukturë të lëvizshme për qëllime komerciale në pronë.

37. Në kërkesën nr. 16518 e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës depozitoi vendimin e ndarjes të vitit 1978 që i miraton atij të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit dhe lejen për të ndërtuar një strukturë të përkohshme për qëllime komerciale në pronë.

38. Kërkesa nr. 33936, e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se e ka të drejtën e shfrytëzimit për objektin komercial, pikërisht dyqanin, për të cilin pretendon se e ka humbur posedimin për shkak të konfliktit. Paraqitësi i kërkesës deklaron se dyqani është uzurpuar në mënyrë të paligjshme nga person i panjohur. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur si dëshmi një marrëveshje për ndarjen midis paraqitësit të kërkesës dhe ndërmarrjes "SLLOGA" të datës 22 gusht 1994, që i miraton atij ndarjen e tokës dhe lejen për të ngritur një strukturë të përkohshme për qëllime komerciale në parcelën e tokës.

39. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesa për riposedimin e pronës private duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Nisur nga fakti që paraqitësve të kërkesës në kërkesat nr. 08840, 16518 dhe 33936 kanë përfituar të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit për pronat e kërkuara dhe janë autorizuar të ndërtojnë vetëm strukturë të përkohshme, Komisioni konsideron se pronat e kërkuara kanë të bëjnë me prona të luajtshme dhe jo me pronën e paluajtshme private. Rrjedhimisht kërkesat duhet të hidhen poshtë. Vendimi i Komisionit nuk cenon çfarëdo të drejtë që mund të kenë paraqitësit e kërkesës për të kërkuar kompensim para gjykatave vendore për investimet që kanë bërë në pronat e kërkuara apo rritjen e vlerës.

g. Kërkesa nr. 11220

40. Kërkesa nr. 11220, e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon të jetë pronar i pronës së kërkuar, pikërisht një magazine për të cilën pretendon se e ka humbur posedimin në vitin 1999 për shkak të konfliktit të 1998-99. Megjithatë, me pas, paraqitësi i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se kishte shitur pronën. Fakti që paraqitësi i kërkesës ka pasur mundësinë të tjetërsojë pronën vullnetarisht, tregon se ai ka pasur mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore në kuptim të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-u 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë.

h. Kërkesa nr. 11554

41. Kërkesa nr. 11554, e referuar në pjesën E të listës së bashkangjitur është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka ndërruar jetë në mars 2010. Bashkëshortja e të ndjerit tregoi se kishte interes për të marrë pjesë në procedurë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare.

42. Pala përgjegjëse i cili po e shfrytëzon aktualisht pronën pretendon se ai po e shfrytëzon atë me lejen e palës së tretë Avdullah Pupi dhe të paraqitësit të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës e mohon se pala përgjegjëse e shfrytëzon pronën me pëlqimin e tij dhe për rrjedhojë kërkesa konsiderohet si kontestuese.

43. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ai dhe pala e tretë Avdullah Pupi kanë qenë bashkëpronarë të një biznesi furnizimi që ata ngritën në vitin 1976 dhe të lokalit të biznesit që ndodhet në pronën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës pohon se ai i ka dhënë Z Pupi shumën prej 30 000 DM për objektin dhe kështu u bë bashkëpronar. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës ofroi si dëshmi vendimin administrativ të lëshuar nga Komuna e Prishtinës datë 22 qershor 1976. Vendimi e lejon Avdullah Pupin të ushtrojë biznesin në pronën e kërkuar. Megjithatë Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të verifikojë dokumentin si të vërtetë. Paraqitësi i kërkesës paraqiti gjithashtu kontratën e qirasë midis Komunës së Prishtinës dhe Avdullah Pupit që i jepte Avdullah Pupit të drejtën për të shfrytëzuar pronën e kërkuar dhe ndërtimin e një objekti të përkohshëm biznesi mbi të. Ndonëse ky dokument është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si i vërtetë, ai vetëm dëshmon të drejtën e Avdullah Pupit për pronën e kërkuar, por nuk dëshmon asnjë të drejtë për paraqitësin e kërkesës. Paraqitësi i kërkesës ofroi gjithashtu vendimin administrativ për ndarjen e taksave i cili ka të bëjë në të vërtetë me biznesin e mbajtur nga paraqitësi i kërkesës. Megjithatë, vendndodhja e biznesit nuk përcaktohet në vendim dhe për rrjedhojë vendimi nuk ka vlerën e provës për këtë qëllim. Sekretaria Ekzekutive e gjeti *ex officio* fletën poseduese për pronën e kërkuar datë 13 korrik 2011 dhe konstatoi se prona është e shënuar si pronë shoqërore. Dokumenti nuk tregon të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar.

44. Komisioni vëren se asnjë nga dokumentet të cilat janë paraqitur nga paraqitësi i kërkesës ose të siguruara nga Sekretaria Ekzekutive dhe të paraqitura ne Komision nuk vërteton të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar.

45. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të vërtetojë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar dhe kërkesa duhet të refuzohet.

i. Kërkesat nr. 11582 dhe 11589

46. Kërkesat nr. 11582 dhe 11589 të referuara në pjesën D të listës së bashkangjitur, janë paraqitur të dyja nga përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të kërkesës në të cilat kërkohet në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësit e kërkesave kërkojnë të drejtën e shfrytëzimit për pronat e kërkuara pikërisht dyqane pasi të dy kanë marrëveshje qiraje me ndërmarrjen shoqërore "Kosovotrans". Përfaqësuesi i autorizuar paraqiti një marrëveshje qiraje sa i takon pronave të kërkuara midis paraqitësit respektiv të kërkesës dhe ndërmarrjes. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk pati mundësi të verifikojë dokumentet. Më tej,

sipas marrëveshjes së qirasë afati i qirasë për kërkesën nr. 11582 përfundoi më 10 korrik 2000 dhe në kërkesën nr. 11589 më 1 gusht 1999 respektivisht. Pala përgjegjëse është ndërmarrja shoqërore "Kosovotrans". Ndërmarrja është nën administrimin aktual të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Përfaqësuesi i autorizuar deklaroi se marrëveshja e qirasë ka skaduar dhe meqë ato nuk janë vazhduar paraqitësit e kërkesës nuk kanë të drejtë pronësore.

47. Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësit e kërkesave kanë dështuar të dëshmojnë të drejtën aktuale pronësore për pronat e kërkuara. Rrjedhimisht kërkesat duhet të refuzohen.


B. Kërkesa për kompensim

48. Në kërkesën nr. 10024 paraqitësi i kërkesës, kërkon gjithashtu përveç pronësisë, kompensimin për demin fizik ose për humbjen e shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK/REG-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Për rrjedhojë kërkesa duhet të hidhet poshtë.

C. Vërejtje përmbledhëse

49. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

50. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA10000
KPA10024
KPA13140

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA00057

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA01135
KPA16127

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part D/Pjesa D/Deo D

KPA11220	KPA00034	KPA00066	KPA00121	KPA11582	KPA11589	KPA33936
KPA00064	KPA00086	KPA00974	KPA08840	KPA16518		

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part E/Pjesa E/Deo E

KPA11554						
----------	--	--	--	--	--	--